

SEIT MANSAKU

RRETH FORMAVE TË SHPREHJES SË RAPORTEVE KUSHTORE NË SHQIPEN E SOTME LETRARE

Ndër marrëdhënjet e ndryshme midis sendeve dhe fenomeneve të realitetit objektiv marrëdhënjet kusht-pasojë kanë shtrirje të gjërë, sepse çdo send ose fenomen mund të jetë kusht për lindjen e një sendi a fenomeni tjetër ose pasojë e një kushti të caktuar. Shtrirja e gjërë e marrëdhënjeve kusht-pasojë në botën objektive, përcakton edhe dendurinë e shprehjes së raporteve të tilla në gjuhë.

Në këtë punim do të bëjmë fjalë për shprehjen e raporteve kusht-pasojë, duke mos u kufizuar vetëm në periudhën me fjali të varur kushtore, por duke vështruar edhe ndërtime të tjera që shprehin raporte të këtij lloji. Kjo mënyrë të vështruar jep mundësi që problemi të rrokët më gjërë, dhe të vihen në dukje jo vetëm ndërtimet tipike që shprehin këto marrëdhënje, por edhe ndërtime të tjera ndër to edhe ndërtime me gërshetime raportesh ose me nuanca të veçanta kuptimore e stilistike.

Raportet kushtore në gjuhë shprehen në mënyrë të ndryshme, që dallohen në mes tyre si nga ana strukturore dhe kuptimore. Semantika e kushtit në ndërtime të ndryshme, mund të jetë e vetmja, mbizotruese ose një nuancë suplementare. Sipas tipeve strukturore, dhe sipas shkallës së qartësisë së semantikës së kushtit, po rendisim këtu format e ndryshme të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare:

1. Periudha me fjali të varur kushtore
 - a) Periudha me fjali të varur lidhëzore kushtore
 - b) Periudha me fjali të varur kushtore jolidhëzore që e ka foljenkallëzues në mënyrën lidhore.
 - c) Periudha me fjali të varur kushtore me format foljore të pa-shtjellura: përcjellore dhe pjesore të tipit *pa punuar*.
2. Periudha me fjali asindete.
3. Periudha me fjali të bashkërenditura që shprehin edhe marrëdhënje kushtore.
 - a) Disa periudha me fjali të bashkërenditura veçuese.
 - b) Disa periudha të ndërtuara me lidhëzat bashkërenditëse *dhe edhe*.
 - c) Disa periudha të ndërtuara me lidhëzën kundërshtore *po, por*
4. Periudha me fjali të tjera të varura që shprehin dhe marrëdhënje kushtore.
 - a) Disa periudha të ndërtuara me lidhëza kohore.
 - b) Disa periudha me fjali të varur shkakore.
 - c) Periudha me fjali kryefjalore me përemra lidhorë të pacaktuar.
 - ç) Periudhat me fjali krahasore të rritjes përpjestimore.
5. Plotësorët e kushtit.

1. a. Periudha me fjali të varur lidhëzore kushtore është mënyra më e zakonshme e shprehjes së raporteve kusht-pasojë. Në këtë lloj periudhe raportet kushtore gjejnë shprehje më të qartë, më konkrete, prandaj, kryesisht kjo është trajtuar nga gramatikanët tanë në sintaksat e gjuhës shqipe të hartuara në përgjithësi për qëllime shkollore ¹.

Nga një autor tek tjetri problematika e periudhës me fjali të varur kushtore ka ardhur duke u rritur në gjerësi dhe thellësi; ajo vjen e vështrohet në më shumë aspekte, përkufizimet plotësohen, nxirren në pah mënyra të reja të shprehjes dhe mjete të lidhjes ².

Një monografi të plotë i ka kushtuar periudhës hipotetike M. Lambertz ³. Autori bën një trajtim të shumanshëm të saj, nga ana strukturore dhe kuptimore. Jep një pasqyrë pak a shumë të plotë të ndërtimeve më të zakonshme, të lidhëzave që shërbejnë për shprehjen e raporteve kushtore duke parë dhe trajtat mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues që përdoren me këto lidhëza në korelacion me trajtat mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues të fjalisë drejtuese.

Sidoqoftë, trajtimet gramatikore janë të kufizuara nga qëllimi i teksteve dhe punimi i M. Lambertzit, me gjithë meritat e pamohueshme të tij, i mbështetur në një material kryesisht dialektor, i hartuar para 50 vjetëve nuk i përgjigjet shkallës së sotme të zhvillimit të gjuhës sonë. Materialet e shumta folklorike të grumbulluara gjatë këtyre viteve, zhvillimi i madh i gjuhës letrare në këto vitet e fundit, pasurimi i saj me mënyra e mjete të reja shprehëse e bëjnë të nevojshme dhe të mundshëm një studim të ri të kësaj kategorie sintaksore. Megjithatë këtu nuk do të trajtojmë periudhën me fjali të varur kushtore në tërësinë e saj, por duke e parë atë si një nga format kryesore të shprehjes së raporteve kushtore, do të cekim ndonjë problem të saj.

* * *

Periudha me fjali të varur kushtore është ndër periudhat më të përdorura në gjuhën shqipe. Ajo paraqitet shumë e larmishme nga ana strukturore dhe kuptimore; zotron një numër të mjaftueshëm mjetesh shprehëse dhe ngërthen nuanca të shumta kuptimore, të cilat duhen marrë parasysh në klasifikimin e tipeve të ndryshme të saj. Ajo mund të vështrohet sipas tipeve të ndryshme strukturore, sipas kuptimeve modale që shprehen në ndërtime të caktuara, d.m.th. sipas punës që veprimet paraqiten si reale, të mundshme ose ireale dhe sipas asaj që shprehin

1) I. D. Sheperi, *Gramatika dhe Sintaksa e gjuhës shqipe*, Vlorë 1927, f. 195; A. Xhuvani, *Sintaksa shqip*, pjesë e dytë, Tiranë 1934, f. 40-41; J. Rrota, *Syntaksa e gjuhës shqipe*, botim i dytë, Shkodër 1934, f. 92-94; K. Cipo, *Sintaksa*, Tiranë 1952, f. 95-96; M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe*, pjesa e dytë, sintaksa, botim i tretë, Tiranë 1957, f. 193-199; S. Prifti, *Sintaksa shqipe*, tekst për institutet pedagogjike dyvjeçare, dispensa II, pjesa I f. 250-275; M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, II, (dispensë) Tiranë 1966, f. 120-127.

2) Në mënyrë më të plotë është trajtuar periudha kushtore nga M. Domi në gramatikat e hartuara prej tij për shkollat e mesme përk. fakultetin histori-filologji dhe nga S. Prifti në dispensën e vet për institutet pedagogjike dyvjeçare. Çështje të veçanta të shprehjes së raporteve kushtore janë trajtuar edhe nga E. Çabej në *Parimet e linguistikës* (dispensë) f. 44-45 dhe sidomos nga S. Floqi në punimet e veta për fjalitë e varura dhe në monografinë për të folmen e Dangëllisë.

3) M. Lambertz, *Die hypotetische Periode im Albanischen*, ne «Indogermanische Forschungen», 1914-15, vll. 34.

kusht të mirëfilltë a kusht të gërshetuar me nuanca të tjera kuptimore.

Klasifikimi strukturor, duke treguar dhe kuptimet modale që mund të shprehen në çdo tip, jep më tepër mundësi për të zbuluar të gjitha ndërtimet që zotëron gjuha për shprehjen e raporteve kushtore.

Lidhur me klasifikimin sipas kuptimeve modale: realitet, mundësi, irealitet, mund të bëhen këto vërejtje:

Së pari, periudha hipotetike e vështruar në tërësi, në thelb mbështetet në një supozim që mund të spikasë më shumë ose më pak në tipe të ndryshme të kësaj periudhe; prandaj, nga kjo pikëpamje është më e saktë për të bërë fjalë për periudhë kushtore të *mundësisë* dhe të *pamundësisë* dhe jo për periudha kushtore reale.

Së dyti, është vështirë të përcaktohet kuptimi real a i mundshëm i periudhës me fjali të varur kushtore, sepse kemi dy fjali që shprehin dy veprime a gjendje me modalitet të njëjtë ose të ndryshëm. Mundet që veprimet e të dy fjalive të pohohen si fakte reale, të mundshme ose njeri real dhe tjetri i mundshëm dhe anasjelltas.

Së treti, në goftë se për periudha kushtore reale bëhet fjalë duke pasur parasysh vetëm modalitetin e fjalisë drejtuese, kurse veprimin e fjalisë së varur, kushtin, e marrin si fakt real, kjo nuk gjen gjithmonë shprehje të qartë gramatikore, prandaj është më shumë subjektive.

Së katërti, vetë periudha kushtore e pamundësisë që karakterizohet kështu nga puna se në një moment të dhënë mundësia e vërtetimit të saj nuk egziston më, e vështruar nga pikëpamja se si pohohet veprimi i fjalisë drejtuese ndaj veprimit të fjalisë së varur, duhet të dallohet në *reale* dhe të *mundshme*. Kjo tregon se periudha kushtore e pamundësisë nuk dallohet si e tillë në bazë të po atij kriteri sipas të cilit dallohen periudha kushtore *reale* dhe *potenciale*. Për të gjitha këto arsye, ndoshta do të ishte më mirë që periudhat kushtore nga pikëpamja e kuptimit modal, të ndaheshin në dy grupe kryesore: *potenciale* dhe *ireale*. Kështu, për të realizuar këto dy kuptime gjuha shqipe ka dhe ndërtime të veçanta, që dallohen qartë nga korelacioni kohor midis fjalisë së varur kushtore dhe fjalisë drejtuese.

Një çështje tjetër që lidhet me klasifikimin e periudhës me fjali të varur kushtore është dhe trajtimi i disa periudhave që, edhe pse kanë në përbërjen e tyre një lidhëz kushtore, të shumtën e herës lidhëzën në *goftë se*, e kanë humbur kuptimin kushtor. Pa dyshim, që këto duhen dalluar nga periudha të tjera kushtore. Në disa prej gramatikave tona këto janë quajtur periudha kushtore formale a të rreme⁴.

Përdorimi i termit fjali kushtore formale a të rreme është konvencional, bile ndoshta i qortueshëm, për arsye se mbështetet vetëm në hetimin e mungesës së një raporti d.m.th. në mohimin e tij dhe nuk zbulon raportin e vërtetë, përmbajtjen e periudhës. Së dyti, një term i tillë do të kishte vend edhe për disa periudha të tjera me fjali të varura ku vihet re humbja e raportit kryesor dhe shprehja e një raporti tjetër të dytë.

Për këto periudha është thënë se shprehin raporte kundrie e krahasimi. Megjithatë saktësimi i analizës së mëtejshme të këtyre periudhave, përcaktimi më i saktë i raporteve që shprehin dhe sidomos shkaqet e mospërputhjes së strukturës së tyre formale me raportet kuptimore mben për t'u vështruar më thellë.

4) S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa II, dispenca II, 1962, f. 252; M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe* (dispensë) 1968, f. 127.

Mungesa e raporteve kushtore në këto periudha provohet edhe nga puna se përmbajtja e fjalisë së varur me lidhëz kushtore është një fakt i kryer, pra veprimi i foljes-kallëzues të saj është vërtetuar, prandaj nuk ka vend për supozim a hipotezë që përbëjnë bazën e kuptimit kushtor. P.sh. kështu, *në qoftë se* në pesëvjeçarin e tretë rithmi i rritjes mesatare vjetore të prodhimit industrial e bujqësor, të marra së bashku, ka qënë 6,7% kundrejt 8,6% që ka qënë në pesëvjeçarin e dytë, në pesëvjeçarin e katërtë dy rithëm ngrihet në 10% (M. Shehu, Raport 97). *Në qoftë se* babai është shtylla e shtëpisë, ajo është drita që e ndrit shtëpinë. (N. Jorgaqi, Dashuria e Mimozës, 99).

Në këto raste, konstrukti hipotetik përdoret për të përqsaur dy veprime a gjendje të krahasueshme midis tyre, për të vënë në dukje më mirë atë që synojmë. Këto periudha për nga raportet që shprehin janë të krahasueshme me fjalitë e bashkërenditura me lidhëzën *ndërsa* dhe me lidhëzën *kurse*, në ato raste kur kjo është e ndërkëmbyeshme me *ndërsa*, megjithatë dallohen midis tyre nga nuancat kuptimore stilistike. Në periudhat me *ndërsa* faktet pohohen pa asnjë nuancë dyshimi, prandaj dhe përqsasja është më e spikasur se në periudhat me *në qoftë se*. Veçanti strukturore e periudhave me *në qoftë se* që shprehin përqsasje, është prepozicioni i detyruar i fjalisë së cilës i prin lidhëza.

Sikurse shihet, këto periudha vetëm nga ana strukturore (prania e lidhëzës nënrenditëse kushtore) janë të nënrenditura, ndërsa nga vlera kuptimore e tyre janë të bashkërenditura, prandaj mund të përfshihen në një tip të veçantë periudhash, në periudha me fjali opozicionale.

Në disa periudha që e kanë humbur kuptimin kushtor, fjalia e varur ka kuptim shkakor, arësytet shkaku e kryerjes së veprimit të fjalisë drejtuese, por shkaku paraqitet nga folësi si i dyshimtë ose fjalia përmban nuanca stilistike. P.sh. *Në qoftë se* këto që them duken si parime të përgjithshme, atëhere po i bëj më konkrete. (E. Hoxha, Revolucionarizimi, 4.) *Në qoftë se* për të qënë patriot u dashka të jesh i varfër, atëhere le të jem i varfër. (F. Paçrami, Dy drama, 41.)

Kuptimin kushtor e kanë humbur edhe disa konstrukte të ndërtuara me lidhëza kushti, që nga ndonjë gramatikan janë quajtur fjali kushtore ndajshimore⁵. Në këto periudha lidhjet kusht-pasojë mungojnë; brendia reale e fjalisë drejtuese nuk kushtëzohet nga brendia e fjalisë së varur. Fjalia drejtuese shpjegon arësytet e vërtetimit të një fakti të njohur, të sigurtë, vërtetimi i të cilit, nuk vihet në dyshim: P.sh. *Në rast se* kompletet e shëmtuara dhe agresioni i imperializmit amerikan kundër Kubës kanë dështuar dhe do të dështojnë edhe në të ardhmen, kjo i detyrohet vendosmërisë së popullit kuban. (E. Hoxha, Raport, 10). Mos harro dhe diçka tjetër: *në qoftë se* nuk të përmendi para gjyqit, këtë nuk e bëri ashtu kot. (F. Paçrami, Dy drama, 110).

Në këto periudha, mendojmë ne, fjalia e varur nuk është ndajshimore, ajo nuk sqaron përmbajtjen e një përemri dëftor, përkundrazi përemri dëftor rimerr në formë të përmbledhur përmbajtjen e fjalisë së varur. Rimarrja e fjalisë së varur me anën e një përemri dëftor kushtëzohet nga prepozicioni i saj. Këto fjali kryejnë në periudhë funksionin e fjalive kryefjalore ose kundrinore prepozitive, ndërsa lidhëzat kushtore shërbejnë si lidhëza ffilluese. Periudhat e mësipërme mund të zëvendësohen kështu: Që kompletet e shëmtuara dhe agresioni i imperializmit

5) S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa II, dispenca II, 1962 f. 267.

amerikan kundër Kubës kanë dështuar dhe do të dështojnë dhe në të ardhmen, kjo i detyrohet vendosmërisë së popullit Kuban. Mos harro dhe diçka tjetër: që nuk të përmendi para gjyqit, këtë nuk e bëri ashtu kot. Në të dyja rastet, në shembujt me lidhëza kushtore dhe në zëvendësimet e tyre me lidhëza ftilluese, në përgjithësi kuptimi i periudhës nuk ndryshon, veçse në rastin e dytë, për vetë veçantinë e lidhëzës, pohimi që bëhet në fjalinë e varur paraqitet më real, pa asnjë nuancë supozimi.

Në periudhat me fjali të varura kryefjalore dhe kundrinore prepozitive të ndërtuara me lidhëzat ftilluese *se, që*, rimarrja e fjalisë së varur në fjalinë kryesore, me anë të një përemri dëftor është një dukuri jo e rrallë për gjuhën shqipe⁶.

Në të vërtetë, raportet kuptimore në periudhat e këtij lloji janë shkakore. Fjalja e varur tregon pasojën ndërsa fjalja kryesore tregon shkakun. Më i qartë del kuptimi i shkakut në periudhën që pason: Po në uroja që ajo të gjente lumturinë, më vinte mirë, përveç kësaj, edhe që ta kisha udhën të hapur (V. Vinçani, Lumturia, f. 6).

Në disa periudha të ndërtuara me lidhëza kushtore lidhjet kusht-pasojë nuk janë të dallueshme, direkte, ajo që pohohet si rrjedhim, në fakt egziston pavarësisht nga realizimi i përmbajtjes së fjalisë kushtore. Fjalja kushtore nuk ka lidhje të ngushtë kuptimore dhe gramatikore me fjalinë drejtuese. Ajo kryen në periudhë funksionin e një fjalie ndërmjetëse. Mund të hiqet dhe megjithatë periudha qëndron formalisht dhe kuptimisht, çka nuk është karakteristikë për fjalitë kushtore të mirëfillta. Në *qoftë se* e ke parë mirë, në lule të ballit ka dy kurora puq me njëra tjetrën, nga e djathta në të mëngjër. (J. Xoxa, Lumi i vdekur, 174). Në e mban ment, quhet Gjyq, një shok i im i vjetër (S. Spasse, Ata, 174). Në *qoftë se* vuan nga gjëkafshë, unë jam doktori... (J. Xoxa, Zemra, 119).

Periudha të kësaj natyre Lambertzi i ka vështruar si periudha kushtore normale, megjithëse pranon që në mes të gjykimit A (protaza) dhe gjykimit B (apodoza) nuk egziston një raport varësie që afirmohet. Nga ana tjetër autori e konsideron të tepërt supozimin e një elipse⁷.

Një tip i veçantë periudhash me lidhëza kushtore janë edhe disa konstrukte tautologjike⁸ dhe jotautologjike por në protazë dhe apodozë kanë si kallëzues të njëjtën folje. Në konstruktet tautologjike meqenëse si në protazë dhe në apodozë shërben si kallëzues e njëjta folje, ajo që pohohet si rrjedhim është e qartë që në parashtrim të kushtit. Në konstruktet jo tautologjike përmbajtja e apodozës mund të përforcojë veprimin që shprehet në fjalinë kushtore ose mund të shtojë nuanca suplementare

6) S. Floqi, Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme «Studime filologjike», 4, 1965, f. 35 thekson: Kur fjalja e varur kryefjalore është fjali «dëftore e zhdrejtë» ose «pyetëse e zhdrejtë» dhe prin fjalinë kryesore (a vartëse) në fillim të kësaj fjalie, fill mbas pauzës (dhe mbas presës, në të shkuar) mund të përdoret për theksim përemri kjo ose ajo, të cilët përfaqësojnë gjithë brendinë e fjalisë së varur dhe mbulojnë, mbushin atë farë këputjeje që është shkaktuar midis fjalive: Që do të shkente në pazar Murat Hasani, kjo ish e vërtetë / Kallamata: Ngj (100) /

7) Edhe në gjuhën shqipe i gjejmë shumë herë ato fjali kondicionale gjoja anormale, sikundër edhe në gjuhën gjermanishtë, në gjuhët romane etj. të cilat janë futë në fjalinë verbale dhe si duket nuk kanë asnjë lidhje me gjykimin e fjalisë kryesore... në mes të gjykimit A dhe gjykimit B nuk egziston një raport varësie që afirmohet. Të tilla konstrukte u përpoqën me i spjegue me ndihmën e elipsës së një apodoze. Por supozimi i një elipse është i tepërt. (Lambertz, punim i cit., sipas përkth. shqip. f. 8).

8) S. Floqi, *Konstruktet tautologjike në shqipen e sotme*, «Studime filologjike», 3, 1963,, f. 46.

duke dhënë dhe vlerësime lidhur me realizimin e tij. P.sh. Në shpëtofsha dot, shpëtova nuku shpëtova, le të pësoj. (Proza II, 299). Ajo është punë që s'bëhet dhe në e bëre vërtetë atë punë, bëre shumë liksht. (Proza, 299). Mirë, nënë, po të mbitem, le të mbitem! (Proza, II, 279). Këto konstruktë, përgjithësisht janë karakteristikë e gjuhës së folur.

Të dobëta janë lidhjet kusht-pasojë edhe në disa periudha kushtore të tipit që pason: Kjo është një kosto shumë e lartë po të marrim parasysh se në vreshtin shtetror të Shkodrës, kostua për një ha ka qenë 148.700 lekë. (M. Shehu, Raport, 20). Në raste të tilla fjalja e varur kushtore shërben për të bërë më të qarta lidhjet kuptimore midis fjalisë kryesore dhe një fjalisë tjetër të varur.

Fjalja kryesore pohon një gjykim, vërtetësia e të cilit provohet ose përforcohet duke u vënë në raport me një gjykim tjetër, duke u ballafaquar me një gjykim tjetër. Pikërisht për të vendosur një raport të tillë midis këtyre, ndërhyjnë fjalja kushtore e cila nuk është gjithmonë e domosdoshme. Karakteristikë e fjalive kushtore të kësaj natyre është se kanë si kallëzues folje e shprehje të tilla: *mendoj, shikoj, vërej, marr në vështrim* etj. Këto konstruktë janë veçori e gjuhës publicistike e shkencore.

b. Periudhat me fjali kushtore jolidhëzore të ndërtuara me mënyrën lidhore shprehin marrëdhënje kusht-pasojë pothuajse po aqë qartë sa edhe periudhat lidhëzore. Mungesa e lidhëzës, mjetit formalo-gramatikor, nuk e pengon dallimin e kuptimit kushtor. Vetë mënyra lidhore shpreh modalitet të mundësisë, të pasigurisë, të supozimit, të dëshirës, prandaj është e aftë për të realizuar lehtë kuptimin hipotetik. Edhe shumica e ndërtimeve lidhëzore me mënyrën lidhore e ruajnë kuptimin kushtor, po t'u heqim lidhëzën. Pra, prania e lidhëzës nuk është element i domosdoshëm për shprehjen e raporteve kushtore në ndërtimet me lidhore. P.sh. Sepse, po të kisha studjuar si duhet, do të kisha mbaruar dhe do të shërbeja diku si gjithë shokët (N. Jorgaqi, Shoku, 8). Të kisha studjuar si duhet do të kisha mbaruar dhe do të shërbeja diku si gjithë shokët. Nga ana tjetër, ndërtimet me mënyrën lidhore pa lidhëz, e pranojnë lidhëzën pa ndryshuar strukturën e tyre. Pikërisht për këto arsye, këto periudha shikohen si ndërtime të veçanta, që anojnë më shumë nga periudhat lidhëzore se sa nga fjalitë asindete.

Mënyra lidhore shpreh raporte kushtore në të gjitha format kohore të saj. Në shumicën e rasteve fjalitë kushtore me mënyrën lidhore janë prepozitive. Të mos ishte *çelur* atë vjeshtë klasa e pestë në fshat të tyre, Mara do të ishte tani në shkollë të Rrëshenit. (Dh. Shuteriqi, Këngë, 17). Të tregohej dhe i prerë Jani për të shkuar në Gjorëm, mund që ai ta dëshpëronte të shoqen, të tregohej i lëkundshëm, — ca më keq, se grua mund të merite kurajë e të hidhej përpjetë (idem, ibidem, 138).

c. Nga format foljore të pashtjellura, në shqipen e sotme letrare, përdoren për të shprehur raporte kushtore përcjellorja dhe pjesorja e tipit *pa punuar*.

Ndërtimet me përcjelloren që shprehin raporte kushtore, janë të rralla si në gjuhën e folur dhe në gjuhën e shkruar. Raportet kushtore në këto ndërtime janë të gërshetuara me nuanca të tjera kuptimore, prandaj nuk dallohen mirë. Për dallimin e tyre, rëndësi të veçantë kanë modaliteti dhe trajtat kohore të foljes-kallëzues të fjalisë drejtuese. Më shpesh folja-kallëzues e fjalisë kryesore është në kohën e ardhme ose në një kohë tjetër me kuptimin e së ardhmes të mënyrës dëftore dhe në mënyrën kushtore. P.sh. Kjo do të arrihet duke vënë në *çfrytëzim*

minierën e re të Alarupit «Lumumba» qysh në vitin 1961. (M. Shehu, Raport, 40). Ky është kusht i domosdoshëm. Por duke e parë çështjen nga pikëpamja problematike, d.m.th. nga pikëpamja se cilat nga këto rregulla themelore përbëjnë problemin më të math për ne sot, mund të themi se, në kushtet tona aktuale, hallkat më të rëndësishme të rregullave të kodit agroteknik, pas të cilave duhet të kapemi fort, «me të dyja duartë» janë tri: (M. Shehu, Raport, 65). *Duke ngritur* sytë përpjetë, nuk shër. shumë gjëra, si thonë disa (N. Bulka, Kur qante, 101). Vetëm *duke punuar* bashkë me punëtorët dhe fshatarët mund të bëhesh komunist i vërtetë. (V.I.Lenin, Veprat, Botim shqip, 1957, vol. 31, 133).

Trajta e pjesores së tipit *pa punuar* përdoret më shpesh se sa përcjellorja, për shprehjen e raporteve kushtore. Kjo trajtë foljore është mohuese, prandaj dhe periudha kushtore e ndërtuar me të tregon se mosrealizimi i një kushti të caktuar sjell domosdo dhe mosrealizimin e asaj që shprehet në fjalinë drejtuese.

Pra, si fjalia kushtore ashtu edhe fjalia drejtuese janë gjithmonë në formën mohuese. P.sh.: Nuk mund të përcaktohet drejtimi i kooperativës ose zhvillimi i degëve të saj *pa marrë parasysh* kushtet e tokës dhe të klimës (E. Hoxha, Raport, 91). Përmirësimi i cilësisë nuk mund të kuptohet *pa rritur* në një shkallë gjithnjë më të lartë kontrollin teknik të gjithanshëm dhe sistematik *pa rritur* ndjenjën e përgjegjësisë personale të njerëzve (Idem, ibidem, 81). *Pa demaskuar* *pa* mëshirë revizionizmin e në radhë të parë klikën revizioniste të Beogradit, nuk mund të bëhet si duhet demaskimi i imperializmit (Idem, ibidem, 149). Vetëkuptohet se politeknizimi i prinë politikëzimi, ideologjia, dhe tek ne në socializëm, nuk mund të ketë politeknizim pa politikëzim të shkollës *pa i dhënë* prioritet absolut edukimit ideologjik marksist-leninist në shkollë, (M. Shehu, Mbi konkluzionet, 75).

Ndërtime të tilla, përdoren më shumë në letërsinë politike për të nënvizuar më me forcë domosdoshmërinë e plotësisht të një kushti, duke treguar, nëpërmjet mohimit, pasojën e dëmshme të mosrealizimit të tij.

* * *

2. Periudha me fjali të varur nuk është e vetmja mënyrë e shprehjes së raporteve kushtore. Gjuha shqipe zotëron edhe mënyra të tjera për shprehjen e tyre. Një nga këto është edhe periudha me fjali asindete.

Në një periudhë asindete me marrëdhënje kushtore fjalia e parë përmban kushtin, ndërsa fjalia e dytë rrjedhimin. Për dallimin e raporteve në fjalitë asindete, dihet, kanë rëndësi të veçantë intonacioni, situata e të folurit, konteksti dhe trajtat foljore. Fjalia që tregon kushtin shqiptohet me intonacion më të ngritur se fjalia që përmban rrjedhimin. Fjalia e parë ka intonacion pyetës, ndërsa e dyta dëftor, urdhërues, këshillues etj.⁹.

Në periudhat asindete me raporte kushtore në origjinë fjalia e parë që përmban kushtin, formalisht ka qenë fjali pyetëse¹⁰, ndërsa fjalia e dytë shprehte një urdhër a këshillë duke u mbështetur në përgjigjen e pyetjes. Mirëpo, me qenë se për folësin përgjigjeja e bashkëbiseduesit

9) Shih S. Floqi *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, BUSHT, 3, 1958, f. 134 dhe M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, II, (dispencë), 1968, f. 142.

10) E. Çabej, *Parimet e linguitikës*. (dispencë), f. 45.

ishte e qartë, sepse shpesh herë pyetja bëhej për një fakt qëndrimi ndaj të cilit ishte i kuptueshëm, folësi nxitonte të jepte rrjedhimin para se të merrte përgjigjen e bashkëbiseduesit. Një dëshmi për këtë është edhe fakti se midis fjalisë së parë dhe fjalisë së dytë bëhet një pauzë, gjatë së cilës folësi duket sikur pret aprovim ose përgjigje për atë që thotë; nga ana tjetër, ka raste kur fjalia që shpreh kushtin paraqitet formalisht si fjali pyetëse. P.sh. Je i zoti, veri gjoksin! S'je i zoti, rri në punën tënde, mos iu ngjit të tjerëve (Q. Buxheli, Kali, 12-13). Ike ti, m'u këputën krahët (Dh. Shuteriqi, Këngë, 134). S'erdhe sot, do të vish nesër. Në mos nesër dikur do të vish. (I. Uruçi, Dy drama, 119). Je i marr' e egërsirë? Dashuria të bën të butë. (Çajupi, Vepra, 303). Bëre ndryshe, gabove. e vure vetëm mbi të gjitha (V. Vinçani, Lumturia, 176). Nuk e hëngre dot, je i humbur që posa të sosësh atje. (Proza, I, 131).

Raportet kushtore në këto periudha nuk dallohen aq qartë, ato mund të gërshetohen me raporte të tjera rrethanore. Sikurse u tha, për dallimin e trye paraqesin interes përveç intonacionit, edhe trajtat foljore. Përgjithësisht fjalia kushtore asindete ka si kallëzues një folje në kohët e mënyrës dëftore, por më të qarta janë marrëdhënjet e kushtit, kur kallëzuesi është një folje në kohën e ardhme ose në ndonjë kohë tjetër me kuptimin e së ardhmes, sepse në këtë kohë realizohet më lehtë kuptimi hipotetik.

* * *

3.a. Një formë e veçantë e shprehjes së raporteve kushtore janë disa ndërtime me fjali të bashkërenditura veçuese të tipit *ose... ose*¹¹.

Dihet se ndër fjalitë e bashkërenditura veçuese, disa prej tyre përmbajnë gjendje e veprime të papajtueshme me njëri-tjetrin, që i kundërvihen njëri-tjetrit. Pranimi a vërtetimi i përmbajtjes së të dy fjalive njëherazi është i pamundur. Midis tyre ekzistojnë marrëdhënje të tilla: supozohen ose parashikohen dy mundësi zgjidhjeje, ndër të cilat preferohet njëra. Pranimi a vërtetimi i përmbajtjes së fjalisë së parë, përjashton mundësinë e realizimit të përmbajtjes së fjalisë së dytë. Pra realizimi i veprimit të fjalisë së parë është kusht i domosdoshëm për mosrealizimin e së dytës. Kur nuk realizohet mundësia e parë, çfaqet varianti i dytë i alternativës i shprehur në fjalinë e dytë. Fjalia e dytë paraqitet si rrjedhim i kushtëzuar nga fjalia e parë. Në të vërtetë, fjalia e dytë është apodozë e një protaze të pashprehur, përmbajtja e së cilës do të ishte gjithmonë mohim i gjykimit të shprehur në fjalinë e parë. P.sh. O besën time ndero, o pragun e shtëpisë nuk e kapërçen i gjallë. (Ll Siliqi, Ringjallja, 44). Fjalia *o pragun e shtëpisë nuk e kapërçen i gjallë* është rrjedhim i supozimit të së kundërtës së asaj që shprehet në fjalinë e parë, d.m.th. rrjedhim i supozimit: *në qoftë se nuk e nderon besën time*. E njëjta gjë vërehet edhe në rastet e mëposhtme: *Ja të më sjellësh pesë okë lesh në mbrëmje, ja të ardhja në shtëpi dhe të sekvestova ç'ke e ç'nuk ke*. (S. Andoni, Maleve 33). *O shpjer kaun në kooperativë e të hyjmë një orë e më parë ose i ndamë lakrat bashkë* (Sh. Musaraj, Të shkuara 58). *Largohu ti! ose do të vihet nderi im në vënd, ose do të derdhet gjak!* (S. Comora, Syleshi, 112). *Ja tregona rrugë, ja të vramë!* (M. Myftiu, Leka, 20). Ne

11) Shprehja e raporteve kushtore me periudha të bashkërenditura veçuese është vënë në dukje nga M. Lambertzi, punim i cit. f. 93 dhe nga S. Floqi, *Periudha e përbërë e bashkërenditur në gjuhën e sotme shqipe*, BUSHT, 2, 1956, f. 40.

duhet të zgjedhim «O të vdesim me nder duke mbajtur vatrat tona, o ta lëm veten të digjemi...» (V. Vinçani, Të rinjtë, 15).

Rastet më të zakonshme të këtyre periudhave, në fjalinë e parë shprehin urdhër, në fjalinë e dytë kërcënim me atë që do të ndodhë, po të mos zbatohet urdhëri.

b. Shpeshherë disa periudha të ndërtuara me lidhëzat bashkërenditëse dhe, edhe të cilat shprehin veprime që vërtetohen njeri pas tjetrit, përmbajnë edhe marrëdhënje kushtore. Pra ato nuk tregojnë vetëm që dy veprimet ndodhin njeri pas tjetrit, por edhe se veprimi i dytë që pason, është i kushtëzuar nga i pari, është rezultat i të parit. Fjalja e parë përmban kushtin, e dyta pasojën. Karakterin e kushtëzuar nuk e tregon mjeti i lidhjes, por brendia reale e fjalive dhe korelacioni i trajtave mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues. Fjalja që përmban kushtin, përgjithësisht e ka foljen-kallëzues në mënyrën urdhërore, ndërsa fjalja e dytë me shpesh në kohën e ardhme ose në kohën e tashme me kuptimin e së ardhmes të mënyrës dëftore. P. sh. Dorzo atë partizanin dhe ty nuk do të bëjmë gjë. (I. Uruçi, Dy drama, 60). M'ep pesë napolona dhe ja marr unë këmishën. (Proza II, 471).

c. Raporte kushtore në një formë të veçantë shprehen shpeshherë, sidomos në gjuhën popullore, edhe me anë të periudhave të ndërtuara me lidhëza bashkërenditëse kundërshtore *po por*. Kushti që shprehet në fjalitë e këtij lloji, është më i dobët se në fjalitë kushtore të mirëfillta; ai mund të mos e pengojë realizimin e veprimit të fjalisë tjetër, por e kufizon atë në një rrethanë të caktuar, pranimi ose mospranimi i së cilës mund të përcaktojë realizimin ose mosrealizimin e asaj për të cilën bëhet fjalë në fjalinë e parë. Nëse kushti është përcaktues *a* vetëm kufizues, kjo sqarohet më mirë nga konteksti. Këto periudha për nga raportet që shprehin janë të ngjashme me periudhat kushtore të ndërtuara me shprehjet lidhëzore *me kusht që, me konditë që*. Veçanti strukturore e këtyre periudhave është se fjalja e dytë që përmban kushtin zakonisht e ka foljen-kallëzues në mënyrën lidhore të paraprirë ose jo nga folja modale *duhet*, në mënyrën urdhërore, ose më rrallë, në kohën e ardhme të mënyrës dëftore. Veçanti tjetër shumë e rëndësishme e këtyre periudhave është intonacioni. Ndryshimi i intonacionit sjell dhe ndryshimin e raporteve dhe si rrjedhim mund të kalohet nga bashkërenditja në nënrenditje, nga një periudhë me fjali kundërshtore që shpreh dhe raporte kushti në periudhë me fjali të varur kushtore. P.sh. S'të ha i thotë macja, *po të veç filan pallat: të porta, të nxjerrë nii çikë brumë*. (Proza, III, 85). Unë nuk dua gjëkafshë tjetër, *po të më japç atë që ke nënë gjuhë*. (Proza, I, 208).

4.a. Nga periudhat me lidhëza kohore, shprehin marrëdhënje kushti ata që tregojnë parakohësi ose njëkohësi, sidomos ata që ndërtohen me lidhëzën *kur*, dhe në gjuhën e folur me lidhëzën *si*¹².

Shprehja e raporteve kushtore me periudha të ndërtuara me lidhëza kohore, bëhet e mundur së pari, sepse koha dhe kushti nuk janë dy rrethana që gjithmonë përjashtojnë njëra-tjetrën, një rrethanë kohore mund të shërbejë edhe si kusht për realizimin e një veprimi; së dyti, si në periudhat me fjali të varura kushtore, ashtu dhe në kohoret e finit që thamë, veprimi i fjalisë së varur kryhet pothuajse gjithmonë përpara

12) Për gërshetimin e raporteve kushtore me raporte kohore shih M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, II (dispensë), 1968, f. 125, 126 dhe S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pjesa II, dispensa II, 1962, f. 259-266.

veprimet të fjalisë drejtuese, nga ana tjetër ky veprim i realizuar në një kohë të caktuar, është shpesh kusht për realizimin e veprimet të dytë që pason.

Ka periudha të ndërtuara me lidhëza kohore në të cilat folësi veprimin e fjalisë së varur nuk e paraqet krejtësisht si fakt real duke nënvizuar vetëm kohën e vërtetimit të tij, por e ven në dyshim vetë praninë e veprimet; pikërisht në periudha të kësaj natyre që përmbajnë dhe një farë supozimi të mundshëm, kuptimi kushtor është më i qartë. P.sh. As-kush nuk mund të thotë se është i lirë, *kur* nuk lufton për çlirimin e të tjerëve dhe në radhë të parë të gruas shqiptare. (E. Hoxha, Mbi problemin, 224). Nuk ka asnjë kuptim mësimi i teorisë marksiste në shkollë *kur* vetë mësuesi ose profesori nuk ka formuar botkuptimin e vetë marksist (M. Shehu, Për zbatimin, 33). Si gjithë çështjet e tjera edhe ato mund të zgjidhen me sukses *kur* bëhen të masave, *kur* tregohet më shumë inisiativë e frymë revolucionare. (E. Hoxha, Raport mbi rolin, 51). Unë kam shtatë djem dhe që të shtatë që kam natën më vinë edhe ditën ikin; prandaj *si* të mos gëzohem natën, *kur* të gëzohem? (Proza, 204).

b. Veprime të kushtëzuara shprehin edhe disa periudha me fjali të varur shkakore. Fjalja e varur shkakore mund të tregojë shkakun e një veprimi të supozuar, d.m.th. mund të jetë apodozë e një fjalie kushtore të pashprehur¹³.

Përmbajtja e fjalisë kushtore të pashprehur është mohimi i asaj për të cilën bëhet fjalinë në fjalinë kryesore. Rastet më të zakonshme të këtyre periudhave janë ato që në fjalinë kryesore shprehin një urdhër, këshilla a porosi ndërsa në fjalinë e varur shkakore tregohet pasoja që do të vijë po të vepohet në kundërshtim me urdhërin e këshillën e dhënë. P.sh. Mos u vono, se do të lë të flesh në lundër pastaj. (S. Pitarka, Familja, 1961)¹⁴.

c. Periudhat me fjali kryefjalore me përmra lidhorë të pacaktuar shprehin marrëdhënje kushtore mjaft të qarta. Kuptimi i papërcaktuar i përemrit lidhor dhe vlera mbarëkohore e trajtave foljore, u jep periudhave me fjali kryefjalore të këtij lloji një përmbajtje përgjithësuëse. Prandaj këto periudha përdoren për të shprehur lidhjet shkakore midis sendeve dhe fenomeneve të realitetit. Sipas brendisë konkrete të fjalive, këto lidhje mund të jenë dhe kusht-pasojë¹⁴. Rëndësi të veçantë për të dalluar lidhjet kusht-pasojë nga lidhjet shkak-pasojë në këto periudha kanë dhe trajtat mënyrore e kohore të foljeve.

Ndërtimet më të zakonshme i kanë foljet-kallëzues të fjalisë së varur dhe fjalisë drejtuese në këto marrëdhënje kohore: dëftore e tashme — dëftore e tashme; dëftore e tashme — dëftore e ardhme, p.sh. *Kush* lufton si burrat, *kush* lufton me gjoks *kush* mbron lirinë e popullit shqiptar, të drejtën dhe nderin e popullit tonë, ai bie në fushën e luftës. (V. Kokona, Me valët, 206). *Kush* pi verën dhe rakinë me një tra e ka shtëpinë (Mbledhës, 139). *Kush* pret shpresën, humbet jetën. (S. Dine, Valët, 702). *Kush* han hudhër do mbanj'erë. (S. Kolea, Një tufë, 48).

ç. Në periudhat me fjali të varur krahasore të rritjes përpjestimore

13) M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, II, (dispensë), 1968, f. 97; S. Floqi, *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, BUSHT, 3, 1958, f. 124.

14) Më hollësisht për këtë shih S. Floqi, *Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme*, «Studime filologjike», 4, 1965, f. 19, 20, 21, 22, 23. Shprehjen e raporteve kushtore periudhat me fjali të varura kryefjalore me përmra lidhorë të pacaktuar e vëren dhe M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, II (dispensë) dhe S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, pj. II, dispensa II, 1962, f. 258, 259.

midis fjalisë së varur krahasore dhe fjalisë drejtuese ka një varësi reciproke që mund të jetë në raport të drejtë ose të zhdrejtë. Shkalla e realizimit të përmbajtjes së fjalisë kryesore, varet, kushtëzohet nga shkalla e realizimit të asaj që shprehet në fjalinë e varur. Në këto periudha kushtëzimi është i pjesëshëm, sepse nuk kushtëzohet plotësisht kryerja e një veprimi a çfaqja e një gjendje të caktuar por shkalla e realizimit të tij a masa e çfaqjes së saj. P.sh. *Sa* më e fuqishme të jetë industria jonë socialiste, *aq* më mirë bëhet ajo një bazë e sigurtë për ecjen përpara të të gjithë ekonomisë me ritme të larta, *aq* më e pathyeshme, më e paprekshme bëhet pavarësia ekonomike e vendit, fuqia mbrojtëse e shtetit tonë të lirë e sovran. (E. Hoxha, Raport mbi rolin, 34). Po dhe mbja qenka si retë e dimrit, *sa* më shumë zbrazen ato, *aq* më fort lehtësohen. (J. Xoxa, Lumi i vdekur, II, 225). S'ka gjë, *sa* më shumë të na vrasin, *aq* më shumë do të shtohemi. (S. Luarasi, Fjala shqipe, 107)

* * *

Periudhat me fjali lejore, ndonëse nga ana formale janë të ngjashme me periudhat kushtore, nuk shprehin raporte kushti, sepse ato në pikën e fundit pohojnë pavarësinë e realizimit të veprimit të fjalisë drejtuese nga realizimi i veprimit të fjalisë së varur¹⁵, bile thelbi i tyre kjo është, që të lejojnë vërtetimin e asaj për të cilën flitet në fjalinë drejtuese, me gjithë pengesat që përmban fjalia lejore.

Edhe kur ato janë të ndërtuara me lidhëzat *edhe në qoftë se, edhe po qe se, edhe sikur, edhe në rast se* përsëri në periudhë nuk ka raporte kushtore. Është e vërtetë se në këto raste në fjalinë e varur supozohet një kusht, por ky nuk arrin të kushtëzojë veprimin e fjalisë drejtuese; prandaj, këto periudha mund të vështrohen si periudha lejore pa gërshtime raportesh lejore — kushtore a kushtore-lejore, duke i dalluar nga periudhat e tjera lejore me lidhëzat *sadoqë, ndonëse, edhe pse, megjithëse*, sepse këto të fundit përmbajnë një fakt real, ndërsa të parat supozim¹⁶. Ne mendojmë se edhe lidhëzat *edhe në qoftëse, edhe po qese, edhe në duhet* të konsiderohen lidhëza lejore.

Është një gjë e njohur formimi i lidhëzave lejore duke u paravënë lidhëzave kushtore, lidhëzat bashkërenditëse shtuese. Latinisht: *etsi* (et = dhe, si = në qoftë se) etiamsi (etiam = edhe, si = në qoftë se) Greqisht: *ei xai* dhe *xai ei*.

5. Raporte kushtore shprehen jo vetëm në periudhë por edhe brenda fjalisë. Një rrethanë kohe, mënyre, vendi etj. e vendosur në një situatë të caktuar mund të kushtëzojë një veprim a një gjendje. Duhet thënë se në këto raste, për të kuptuar raportet kushtore nuk ndihmon *aq* shumë natyra morfologjike e fjalës se sa situata e të folurit, konteksti, intonacioni dhe trajta foljore e kallëzuesit.

a. Rastet më të zakonshme, për shprehjen e raporteve kushtore në fjali janë ato që shprehen me një emër me parafjalët *pa* ose *me*. Mos harroni këshillat e Partisë, vëllezër dhe motra, *se pa barazinë* e plotë të gruas me burrin, *pa unitetin, pa dashurinë* e kthjelltë dhe *respektin* në mes tyre, nuk mund të ndërtohet socializmi dhe jeta e lumtur për po-

15) Shih dhe S. Floqi, *Disa tipe semantiko-strukturore të periudhës me fjali të varur pa lidhje korelative*, «Studime filologjike», 3, 1967, f. 29.

16) Ky dallim bëhet nga M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, II, (dispensë), 1968, f. 128.

pullin me atë shpejtësi dhe me atë hov që kërkon Partia. (E. Hoxha, Mbi problemin, 224). Detyrat e mëdha që ne po shtrojmë në këtë kongres nuk mund të kryhen me sukses *pa forcimin* organizativ të Frontit Demokratik, *pa gjallërimin* e mëtejshëm të jetës së tij, *pa rritjen* e frymës luftarake e vetvepruese të të gjitha organeve dhe organizatave të frontit, pa përmirësuar vazhdimisht metodën dhe stilin e tyre në punë. (E. Hoxha, Raport mbi rolin, 55). Kjo arrihet në radhë të parë *me pjesëmarrjen* e gjerë të grave në ndërtimin e socializmit, në punët e arësimit dhe të kulturës. (E. Hoxha, Mbi problemin, 113).

Marrëdhënjet kushtore janë më të qarta kur parafjalët *me* dhe *pa* janë përdorur me emra foljorë. Ndërtime të tilla në gramatikat tona janë përfshirë në grupin e plotsave të mjetit a të mënyrës. Në kuptimin më të gjerë të mjetit, rastet e mësipërme mund të shikohen si mjete me anën e të cilave arrihet realizimi i një synimi të caktuar, por me një analizë më të imtë semantike dhe gramatikore mund të bëhet diferencimi midis mjetit të mirëfilltë dhe kushtit. Kur emrat e shoqëruar me parafjalët *me* ose *pa* shprehin nocione konkrete, ata shënojnë mjetin, ndërsa kur shprehin nocione abstrakte më shumë shënojnë kushtin që duhet përmbushur për realizimin e veprimit të shprehur nga folja-kallëzues e fjalisë. Nga ana tjetër, këto emra, plotës mjeti ose kushti, përgjithësisht plotësojnë kuptimin e një foljeje, por si plotës mjeti ndonjëherë plotësojnë dhe kuptimin e një emri foljor. Përveç kësaj, kallëzuesi i fjalisë që merr plotës mjeti mund të jetë një folje në çdo mënyrë dhe kohë, ndërsa që të marrë plotës kushti duhet të jetë në disa forma të caktuara, zakonisht në mënyrën dëftore, koha e tashme dhe e ardhme, ose në mënyrën kushtore.

b. Disa ndajfolje mënyre ose kohe: *ndryshe, përndryshe, kështu, atëhere, pastaj*, shpesh herë përmbajnë një kusht të supozuar¹⁷.

Këto ndajfolje zëvendësojnë brendinë e një fjalie kushtore të pa-shprehur, por të nënkuptuar lehtë nga konteksti. Ndajfolja *ndryshe (përndryshe)* paraqet një supozim për të kundërtën e asaj që është thënë më parë, ndërsa ndajfoljet *kështu, atëhere, pastaj* supozojnë praninë e asaj për të cilën është bërë fjalë në një fjali tjetër, dhe në bazë të këtij supozimi pohohet rrjedhimi. P.sh. *Ndryshe*, ajo pamje që bëri Vitën të skuqej e të zemrohej, të vëllanë do ta kish tërbuar fare. (J. Xoxe, Lumi i vdekur, II, 18). Këtu duhet të luftojmë të gjithë, *përndryshe*, asgjë nuk mund të bëjmë. (I. Kadare, Gjenerali, f. 14). Grua, vërtet t'u rrëfyesh njeri, po ti mos kallzo se unë natën bëhem njeri dhe ditën gjarpër, *atëhere* unë jam i ikur dhe ti nuk do të më gjesh më! (Proza I, 399). Dëgjo moj derdimene, ja ku po të lëkurën e gjarprit dhe po bëhem njeri, po shëko se mos e çdukësh, sepse *pastaj* do të mos më shëkosh më. (Proza, 384). *Vetëm kështu*, mendoj unë ata nuk do të kenë frikë dhe ndrojtje nga pyetjet e nxënësve e të studentëve dhe as këta nga pyetjet që do t'u bëjnë mësuesit apo pedagogët. (E. Hoxha, Për revoluc. 46). Po vjen kush e të heton *atëher* e merr lumi mirë punën tonë. (K. Jakova, Dom Gjoni, 74).

c. Kushti mund të shprehet edhe në disa togje fjalësh pa lidhje të ngushtë gramatikore me fjalinë ku bëjnë pjesë, përmbajtja kuptimore e të cilave sqarohet nga kumtimi i bërë më parë. Togje të tilla janë: *në këtë rast, në një rast tjetër, në rast të kundërt, në rast + një emër*

17) S. Floqi, *Periudha me fjali të varur shkakore*, «Studime filologjike» 2, 66, M. Domi, *Sintaksa e gjuhës shqipe* (dispencë), 1968, f. 126-127.

në gjindore ose në rrjedhore. P.sh. Në këtë rast, d.m.th. në qoftë se do ta profilizojmë gjimnazin, atëhere gjimnazi i ardhshëm do të futej thellë në rrugën e politeknizimit dhe nuk do të mbetej ashtu siç është sot, pa profil të caktuar. (M. Shehu, Mbi revoluc. 29). Më 28 prill, pa marrë akoma nga mbreti Nikollë përgjigjen e notës së fuqive të mëdha, Bertholdi i kërkoi konferencës së Ambasadorëve që të merreshin masa shtrënguese kundër Malit të Zi. Në rast të kundërt, ai paralajmëronte se monarkia do të vepronte vetëm (Historia. II, 380). Në jug qeveria greke kishte arritur një marrëveshje me Z. Gjolekën, sipas së cilës në rast të një konflikti të ri, shqiptarët do të mbanin anën e Greqisë (Ibidem, 66). Ajo ishte e sigurt se në rast konflikti me Austro-Hungarinë, do të kishte ndihmën e Rusisë dhe të aleatëve ballkanikë (Ibidem, 356).

Sikurse duket edhe nga ky parashtrim i shkurtër, format e shprehjes së raporteve kushtore në gjuhë janë të shumta. Ato shprehen në periudhë dhe në fjali, por më shumë në periudhë. Periudha me fjali të varur kushtore paraqet një larmi të madhe strukturore dhe kuptimore. Përshkrimi i imtë e tërësor i ndërtimeve që përdoren në gjuhën letrare dhe i atyre që gjenden në gjuhën e folur popullore por që mund të pasurojnë gjuhën letrare me tipe të reja, zbulimi i nuancave kuptimore që shprehen me këto ndërtime, vënja në dukje e mjeteve të reja shprehëse. mbeten detyrat kryesore për thelimin e studimit të kësaj kategorie sintaksore në të ardhmen. Duke bërë një përshkrim tërësor të të gjitha ndërtimeve të periudhës me fjali të varur kushtore në gjuhën shqipe, duhet të dallojmë ato ndërtime që janë bërë ose që kanë prirje për t'u bërë normë e gjuhës letrare dhe mënjanohen nga gjuha ndërtim të nuk janë në përputhje me natyrën e gjuhës sonë.

VEPRAT LETRARE TË PËRMENDURA DHE SHKURTIMET E TYRE

- | | |
|-------------------------------|--|
| Çajupi, Vepra | — Andon Zako Çajupi, Vepra, 1957 |
| Dh. Shuteriqi, Këngë | — Dhimitër Shuteriqi, Këngë në minierë, Tiranë 1968 |
| E. Hoxha, Revolucionarizimi | — Enver Hoxha, Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i Pushtetit, Tiranë 1967. |
| » Raport | — Raport mbi aktivitetin e KQ të PPSH, Tiranë 1961. |
| » Raport mbi rolin | — Raport mbi rolin dhe detyrat e Frontit Demokratik, Tiranë 1967. |
| » Mbi problemin | — Mbi problemin e gruas, Tiranë 1967. |
| F. Paçrami, Dy drama | — Fadil Paçrami, Dy drama, Tiranë 1963. |
| Historia, II | — Historia e Shqipërisë, II, Tiranë 1965. |
| I. Kadare, Gjenerali | — Ismail Kadare, Gjenerali i ushtrisë së vdekur, Tiranë 1963. |
| I. Uruçi, Dy drama | — Ibrahim Uruçi, Dy drama, Tiranë 1968 |
| J. Xoxa, Lumi i vdekur, I, II | — Jakov Xoxa, Lumi i vdekur, I, II, Tiranë 1965. |
| » Zemra | » Zemra, Tiranë 1958. |
| K. Jakova, Dom Gjoni | — Kolë Jakova, Dom Gjoni, Tiranë 1967 |
| Ll. Siliqi, Ringjallja | — Llazar Siliqi, Ringjallja, Tiranë 1959 |

- Mbledhës, III — Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, III, 1962.
- M. Myftiu, Leka — Mehmet Myftiu, Leka, 1960
- M. Shehu, Raport — Mehmet Shehu, Raport mbi direktivat e kongresit V, Tiranë 1966
- » Mbi konkluzionet — Mehmet Shehu Mbi konkluzionet e diskutimit popullor për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, Tiranë 1969
- » Për zbatimin — Mehmet Shehu, Për zbatimin e detyrëve në lidhje me revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës sonë, Tiranë 1968.
- N. Jorgaqi, Shoku — Nasho Jorgaqi, Tiranë, 1968
- Proza, I, II — Folklor shqiptar, Proza popullore, I, II, Tiranë 1963.
- S. Andoni, Maleve — Sotir Andoni, Maleve në shënëndre, Tiranë 1958.
- S. Dine, Valët — Spiro Dine, Valët e detit, 1908.
- S. Kolea, Një tufë — Sotir Kolea, Një tufë proverbash, Tiranë 1958.
- S. Çomora, Syleshi — Spiro Çomora, Syleshi, Tiranë 1958
- S. Luarasi, Fjala shqipe — Skënder Luarasi, Fjala shqipe, Tiranë, 1961.
- S. Pitarka, Familja — Sulejman Pitarka, Familja e peshkatarit, Tiranë 1961.
- S. Spasse, Ata — Sterjo Spasse, Ata nuk ishin vetëm, Tiranë 1966.
- Sh. Musaraj, Të shkuara — Shefqet Musaraj, Të shkuara të paharruara, Tiranë 1957
- V. Kokona, Me valët — Vedat Kokona, Me valët e jetës. I, Tiranë 1961
- V. Vinçani, Lumturia — Vandush Vinçani, Lumturia, Tiranë 1965
- » Të rinjtë, Tiranë 1958

R é s u m é

A PROPOS DES FORMES D'EXPRESSION DES RAPPORTS
CONDITIONNELS EN ALBANAIS LITTERAIRE DE NOS JOURS

Dans son exposé, l'auteur examine l'expression des rapports conditionnels non seulement dans les phrases complexes à subordonnée conditionnelle, mais également dans d'autres constructions de phrases à coordination ou à subordination, qui, outre les autres sens, expriment, dans des contextes donnés, aussi des rapports conditionnels. L'auteur examine, également, l'extériorisation des ces rapports dans le phrase complexe, à l'aide des compléments conditionnels.

D'après les différents types structurels et la clarté sémantique de la condition, l'auteur range les suivantes formes d'expression des rapports conditionnels:

1. Phrase complexe à subordonnée conditionnelle:
 - a) Phrase complexe conjonctive conditionnelle;
 - b) Phrase complexe à subordonnée conditionnelle, construite à l'aide du subjonctif sans conjonction;
 - c) Phrase complexe à subordonnée conditionnelle construite à l'aide des formes verbales implicites: gérondif et participe du type pa punuar.
2. Phrase complexe à proposition asyndète.
3. Phrase complexe à proposition coordonnée, exprimant aussi des rapports conditionnels:
 - a) Quelques phrases complexes à propositions coordonnées divisionnelle;
 - b) Quelques phrase complexes à propositions coordonnées à l'aide des conjonctions dhe, edhe;
 - c) Phrases complexes à proposition coordonnée à l'aide des conjonctions adversatives po, por.
4. Quelques autres phrases complexes à subordonnée exprimant aussi des rapports conditionnels:
 - a) Quelques phrases complexes à proposition temporelle;
 - b) Quelques phrases complexes à proposition causale;
 - c) Phrases complexes à proposition comparative d'accroissement proportionnel.
5. Compléments conditionnels.

A propos de la phrase complexe à subordonnée conditionnelles, comme principale forme d'extériorisation de ces rapports, l'auteur s'arrête brièvement sur ses sens de modalité. Il croit que la phrase complexe à subordonnée conditionnelle, considérée au point de vue de la modalité, doit être distinguée en potentielle et réelle. Les sens de modalité de la réalité et de la possibilité ne sont pas distingués toujours à l'évidence par des moyens grammaticaux.

L'auteur met son attention aussi sur ces périodes, lesquelles, même si elles ont une conjonction conditionnelle, ont perdu le sens de la condition et extériorisent d'autres rapports. Elles peuvent indiquer une comparaison (ex.: kështu, në qoftë se në pesëvjeçarin e tretë ritmi i rritjes mesatare vjetore të prodhimit industrial e bujqësor të marra së bashku ka qenë 6.7% kundrejt 8.6% që ka qenë në pesëvjeçarin e dytë, në pesëvjeçarin e katërt ky ritëm ngrihet në 10% — M. Shehu, Mbi direktivat 97); ou encore elles expriment des rapports causaux (ex.: Në qoftë se këto që po them duken si parime të përgjithshme, atëhere po i bëj më konkrete — E. Hoxha, Revolucionarizimi 4). L'auteur analyse également quelques phrases complexes qui ont le sent conditionnel affaibli, où la proposition conditionnelle s'introduit comme une proposition intermédiaire.

Pour ce qui est des proposition asyndètes à rapports conditionnels, l'auteur s'arrête sur la portée de l'intonation et les formes temporelles des verbes-prédicats, afin de faire distinguer les rapports de cause à effet des autres rapports.

Durant le traitement de l'expression des rapports conditionnels par d'autres constructions coordonnées ou subordonnées, l'auteur tâche d'y découvrir la spécifique de ces rapports et les situation effectives où ces constructions expriment la condition ou l'hypothèse.

Sur l'expression des rapports conditionnels dans la proposition l'auteur insiste, sur les noms, comme principaux moyens, notamment sur les noms verbaux avec les prépositions pa et me; sur quelques adverbes de manière et de temps: ndryshe, përndryshe, kështu, atëhere, pastaj; sur quelques groupes de mots: në këtë rast, në një rast tjetër, në rast të kundërt, në rast + un nom au génitif ou ablatif.

A la fin de son article, l'auteur considère que les formes d'extériorisation des rapports conditionnels en albanais sont nombreux. La phrase complexe à subordonnée conditionnelle offre une variabilité infinie au point de vue de la structuration et du sens. La description totale des constructions qui interviennent dans l'albanais littéraire, la mise au jour des nuances sémantiques qu'extériorisent ces constructions, la mise en évidence des nouveaux moyens d'expression, restent les tâches principales en vue d'approfondir l'étude de cette catégorie syntaxique à l'avenir.